



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 30
Prishtinë, më 10.7.2018, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

Morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Nezir Çoçaj, Valentina Bunjaku – Rexhepi, Driton Çausi, Abdyl Salihu, Mufera Shinik, Fidan Rekaliu, Verica Çeraniq dhe Albulena Balaj – Halimaj.

Mungoi: Arbërie Nagavci.

Përfaqësues të tjerë: Përfaqësues nga BE, KDI, mediat

Stafi mbështetës i komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 2.7.2018;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99;**
4. **Shqyrtimi i aplikacioneve të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë;**
5. **Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen, sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 2.7.2018

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur me datë 2.7. 2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtim i projektligjit nr. 06L/073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99

Ismajl Kurteshi, tha se projektligji ka kaluar në leximin e parë dhe që janë mbajtur dy debate publike, ku janë marrë komente nga SBASHK-u dhe nga Banka Botërore, kurse nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, edhe pse kanë kërkuar komente me shkrim prej tyre, nuk kanë pranuar. Ai tha se ligji duhet të shqyrtohet nen për nen dhe të gjitha komentet që vijnë nga palët tjera.

Teuta Haxhiu, tha se dy ministrinë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e sidomos Ministria e Financave, që ka bërë një propagandë edhe pse kanë dhënë nënshkrimin e tyre, nuk kanë sjellë asnjë koment më shkrim, gjë që tregon për mosinteresimin e tyre. Ajo tha se MASHT-i dhe SBASHK-u është dashur të sjellin të dhënat e sakta që janë faktike mbi numrin e saktë të mësimdhënësve, në vitin tjetër dhe planifikimin për 3 vite, pasi që, sipas saj, nuk është një kosto e papërbalueshme. Në fund, ajo shtoi se është në interes të komisionit që ligji të jetë i zbatueshëm.

Nezir Çoçaj, tha se dëgjimet publike janë mbajtur dhe nuk ka nevojë për diskutime. Ajo që i mbetet komisionit, është të trajtojë ligjin nen për nen, si dhe të fokusohet vetëm te sektori i arsimit, sepse askush nuk mund të krahasohet me këtë kategori.

Driton Çausi, tha se përshtypja e tij nga dy dëgjimet publike të mbajtura, është se kjo çështje nuk e ka vendin në Komision për Arsim. Ai tha se komisioni mund të shërbejë si një komision për të dhënë një gjykim moral në lidhje me nevojën e kompensimit të punëtorëve të arsimit, mirëpo kjo çështje i takon ekspertëve të financave, por që ende nuk ka qartësi nga institucionet e Kosovës, që ky ligj nuk përben asnjë ngarkesë për qëndrueshmërinë e buxhetit.

Fidan Rekalii, tha se është shumë e rëndësishme që komisioni është unik, sa i përket këtij ligji, mirëpo që edhe ministrinë përgjegjëse do të duhej t'i kryenin obligimet e veta, karshi këtij ligji.

Ismajl Kurteshi, tha se pajtohet me qëndrimin që, edhe pse ligji ka të bëjë me arsimin, thelbi i tij janë financat, si dhe që ky ligj iu përket njerëzve që janë ekspertë të këtyre çështjeve. Ai tha se me kërkesë të veçantë, në punën e mëtutjeshme të komisionit, duhet obliguar dy ministrinë, përveç MASHT-it, edhe të Financave dhe të Mirëqenies Sociale, që të jenë pjesë e punës së komisionit, si dhe të ofrojnë informata të sakta mbi numrin dhe përfituesit e këtij ligji. Gjithashtu, ai tha se komisioni ka mundësinë që të kontraktojë një ekspert të jashtëm për trajtimin e këtij projektligji, mirëpo që i mbetet komisionit të vendosë se me cilën metodë të punojë.

Valentina Bunjaku, tha se në mes të ministrive ka shumë parregullsi, dhe në mënyrë që ky projektligj të jetë i zbatueshëm, këto ministri duhet të koordinohen mes vete.

Ismajl Kurteshi, diskutoi mbi organizimin e një punëtorie, lidhur me projektligjin për mësimdhënësit e viteve të 90-ta, në fundjavën që vjen.

Driton Çausi, tha se njëherë duhet vlerësuar se a ka nevojë për të organizuar këtë punëtori për projektligjin për mësimdhënësit e viteve të 90-ta, sepse Ministria e Financave e ka këtë përgjegjësi.

Ismajl Kurteshi, tha se MASHT-i ka marrë përsipër organizimin e kësaj punëtorie, për shkak të ndjeshmërisë dhe efekteve anësore që ka ky projektligj.

Pas diskutimit të anëtarëve të komisionit, u vendos që t'i drejtohem me shkresë MASHT-it, MF-së dhe MPMS-së, lidhur me dërgimin e informatave shtesë për numrin e saktë të përfituesve nga ky projektligj, koston financiare, caktimin e personave përgjegjës për pjesëmarrje në mbledhjet e komisionit gjatë shqyrtimit dhe amendamentimit të projektligjit.

4. Shqyrtimi i aplikacioneve të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë

Ismajl Kurteshi, njoftoi deputetët që këtij Këshilli i kalon afati gjatë këtij muaji dhe që konkursi është shpallur nga Këshilli, në pajtim me komisionin. Të interesuarit kanë dërguar dokumentet në Këshill dhe në Kuvend, të cilat kanë qenë në pliko, të mbyllura, ku komisioni është i autorizuar t'i hapë dhe t'i shqyrtojë, pastaj t'i rekomandojë Kuvendit, një numër të caktuar të atyre që kanë aplikuar, tha ai.

Teuta Haxhiu, tha se me lejen tonë, administrata mund t'i hapë plikot dhe të shohë se kandidatët që kanë aplikuar, a i kanë dërguar të gjitha dokumentet e nevojshme dhe ata që nuk i kanë dërguar, të eliminohen menjëherë, kurse ata që e kanë plotësuar këtë kriter, të ftohen në intervistë. Ajo, gjithashtu, tha se komisioni ka mundësi të dërgojë në Kuvend, 7 emra për 7 pozita ose të dërgojë 14 për 7, për hir të demokracisë.

Valentina Bunjaku, tha se pajtohet me qëndrimin e deputetes Haxhiu, që të gjithë ata që kanë përmbushur kriterin e plotësimit të detyrave, të ftohen në intervistë dhe t'u dërgohet një listë/pako me emra, në Kuvend, që të mos mbetet shumë hapësirë për diskutim.

Muferra Shinik, kërkoi sqarime se a është e sqaruar me ligj edhe përfshirja e komuniteteve pakicë për këtë Këshill.

Ismajl Kurteshi, tha se është e caktuar me ligj, që dy nga anëtarët të jenë prej komuniteteve dhe ata garojnë mes vete. Gjithashtu, ai kërkoi miratimin e deputetëve mbi autorizimin e administratës për hapjen e plikove dhe ndarjen e atyre që i plotësojnë dhe atyre që nuk i plotësojnë kriteret, mirëpo që asnjë nuk guxon të eliminohet.

Në vazhdim, propozoi që të formohet grupi punues për shqyrtim të aplikacioneve, ku mund të marrin pjesë të gjithë anëtarët e komisionit.

Me këtë propozim u pajtuan anëtarët e komisionit dhe unanimisht nxorën këtë

V E N D I M

1. Formohet grupi punues për shqyrtimin e aplikacioneve të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë;
2. Grupi punues ka këtë përbërje: Ismajl Kurteshi kryesues, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Arbërie Nagavci, Driton Çausi, Valentina Rexhepi- Bunjaku, Fidan Rekaliu, Abdyl Salihu, Nezir Çoçaj, Verica Çeraniq dhe Albulena Balaj-Halimaj, anëtarë;
3. Grupi punues, në bashkëpunim me Njësinë koordinuese të Komisionit, do të shqyrtojë aplikacionet e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë dhe do të përgatisë listën e ngushtë të kandidatëve, që i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs.

5. Të ndryshme

Teuta Haxhiu, tha se nga takimi i fundit, administrata është obliguar që t'i drejtohet me shkrim Agjencisë së Akreditimit dhe është dakorduar që takimi me agjencinë të mbahet më datën 20 korrik 2018, kurse takimi me rektorët e universiteteve publike, të mbahet më datën 18 korrik 2018, mirëpo që mbetet ende për t'u konfirmuar.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,
Ismajl Kurteshi